

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6507
E martë, 17 janar 2022
çmimi 0.40

Policia gjatë një aksioni kapi mbi pesë kilogramë drogë




Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NDALOI REFERENDUMIN E SERBISË



Republika e Kosovës përmes një rezolute të miratuar nga deputetët në Kuvendin e Kosovës ka ndaluar referendumin e Serbisë, i paralajmëruar se do të mbahet në disa komuna me shumicë serbe në territorin tonë më 16 janar. Ky vendim nuk u ka pëlqyer qytetarëve serbë të cilët të dielën janë mbledhur në qendër të Mitrovicës së Veriut dhe kanë protestuar kundër vendimit të autoriteteve të Kosovës për të mos lejuar referendumin serb në Kosovë. Votuesit serbë janë detyruar të votojnë në vendvotimet në Kurshumli, Novi Pazar, Rashkë dhe Vranjë, qytete këto që ndodhen afër kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

AKTUALE



VMRO DHE LSDM PËRPLASEN NË KUVEND PËR LEGJITIMITETIN E QEVERISË SË RE F. 6

KOMUNA E PRISHTINËS FURNIZON SHKOLLAT ME TESTE ANTIGJENË F. 6

AMBASADORI AMERIKAN NË REÇAK: TË MOS MOHOHET ÇFARË KA NDODHUR KËTU F. 6

EKONOMI



BQK-JA MERR PJESË NË TAKIMET E KONSTITUENCËS NË BUDAPEST F. 6

ÇFARË PO BËN EVROPA PËR TA ZGJIDHUR KRIZËN ME GAZ? F. 7

SPORT



MALISHEVA MERR EDHE MALIQIN, DUKAGJINI ZYRTARIZON ZHDRELLËN DHE NIKOLIQIN F. 11

Reçica: PDK-ja do të formojë nëndegë në të gjitha qytetet ku jetojnë shqiptarët në Zvicër



VAZHDON SHTIMI I RASTEVE ME COVID NË KOSOVË, BËHET THIRRJE PËR RESPEKTIM TË MASAVE

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VMRO dhe LSDM përplasen në Kuvend për legjitimitetin e qeverisë së re

SHKUP, 16 JANAR - Në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut të dielën, më 16 janar, ka vazhduar debati për zgjedhjen e qeverisë së re që do të drejtohet nga Dimitar Kovačevski, kryetar i Lidhjes Sociale Demokratike.

Debati pritet të zgjasë deri në votimin e përbërjes së re të qeverisë.

Qeveria e re do të ketë 21 anëtarë, 17 ministra dhe 4 zëvendëskryeministra.

Lidhja Social Demokratike do të ketë 12 anëtarë të qeverisë, gjashtë Bashkimi Demokratik për Integritet dhe tri partia Alternativa.

Të dielën debati ka nisur me fjalimet e deputetëve të VMRO DPMNE-së, të cilët thanë se qeveria që do të drejtohet nga Dimitar Kovačevski nuk ka legjitimitet pasi, sipas deputetës së VMRO DPMNE-së, Bllagica Lasovska, "mandatari Kovačevski nuk ka marrë pjesë në zgjedhje, nuk ka kërkuar besimin e qytetarëve dhe nuk ka marrë asnjë votë prej tyre andaj edhe nuk ka legjitimitet për ta drejtuar qeverinë".

Ajo tha se " shumica e ministrave janë vazhdimësi e regjimit hibrid" që u mund në

zgjedhjet lokale disa muaj më parë". "Në kohën kur kemi krizë të rëndë ekonomike, shëndetësore, energjetike dhe mungesë të ngrohjes qendrore, mandatarin për kryeministër flet për gjendje të mirë ekonomike dhe rritje të Prodhimit Bruto Vendor. Si mund të harrojmë se kemi inflacion, se qytetarët nuk kanë as bukë për të ngrënë, kur çmimet e produkteve po rriten, kur paraja po humb vlerën? Kjo është tallje me ndjenjat e qytetarëve", deklaroi deputetja Lasovska. Ndërkaq Marija Georgievska, deputete e LSDM-së, tha se partitë që do të jenë pjesë e qeverisë së re kanë legjitimitet të plotë ta udhëheqin vendin, sepse në zgjedhjet e fundit parlamentare kanë marrë mbështetjen e qytetarëve. "Hristijan Mickoski në zgjedhjet parlamentare nuk ishte bartës i listës dhe kandidat për deputet, pra a do të kishte legjitimitet për të formuar qeveri nëse do të fitonte VMRO-DPMNE dhe koalicioni i tij?" tha Georgievska duke hedhur poshtë pretendimet e opozitës se qeveria nuk ka legjitimitet.



Halil Snopçe, deputet i Aleancës për Shqiptarët, tha se "qeveria mund të quhet e re, por të gjithë anëtarët e saj janë fytyra të vjetra të qeverisë së kaluar të korruptuar dhe të paafte të përballesh me shumë probleme me të cilat përballet vendi".

Ai tha se zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë mënyra e vetme për dalje nga gjendja në të cilën ndodhet Maqedonia e Veriut. Dimitar Apasiev, deputet i partisë "E

Majta", kritikoi përbërjen e qeverisë, respektivisht numrin e madh të ministrave shqiptarë që, sipas tij, flet për tendencën për "shqiptarizimin e Maqedonisë". "11 poste ministrore për maqedonasit dhe 10 për shqiptarët. Pra, kjo është një tirani kornizë, një gjysmë protektorat, një shtet paralel në një shtet ku të rinjtë maqedonas dhe shqiptarë nuk komunikojnë, mosrespektimi i himnit, gjuhës, kurse Bujar Osmani (Ministri i Punëve të Jashtme) duhet të ketë kujdes

se çfarë bën me Bullgarinë", deklaroi Apasiev.

Mandatari për formimin e qeverisë së re, Dimitar Kovačevski, në fjalimin e tij para deputetëve, tha se ka plan konkret për zhvillimin e vendit dhe se puna e qeverisë së re do të përqendrohet në tri prioritete: përballesh me krizën energjetike, pandeminë e koronavirusit, rritjen e standardit jetësor të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe realizimin e investimeve strategjike.

Britania synon heqjen e masave kufizuese kundër Covid-19

LONDËR, 16 JANAR - Qeveria e Britanisë së Madhe ka thënë të dielën (16 janar) se synon t'i largojë masat e fundit kufizuese më vonë këtë muaj derisa vala e infeksionit me Omicron po bie.

Muajin e kaluar Anglia kaloi të "Plani B" në lidhje me masat kufizuese duke vënë në fuqi sërish udhëzimet për punë nga shtëpia dhe kërkesat për pasaportë vaksinimi për të marrë pjesë në ngjarje më të mëdha.

Qeveria do të largojë këto masa më 26 janar, por obligimi për vendosjen e maskës mund të vazhdojë sipas raportimeve.

Ministri Oliver Dowden, bashkëkryetar i partisë konservatore të kryeministrit, Boris Johnson, tha se "shenjat ishin inkurajuese". "Ka qenë gjithmonë shpresa ime që do



të kishim kufizimet e Planit B për periudhën më të shkurtër të mundshme", tha ai në "Sky News". "Unë nuk kam asnjë

dyshim llojin e ngarkesave që kjo i vendos mikpritjes, biznesit më të gjerë, shkollave dhe kështu me radhë dhe unë

dua që ne t'i heqim qafe ato nëse mundemi", tha ai.

Pasi u shfaq varianti Omicron, numri i rasteve ditore me Covid-19 në Britani arriti një rekord prej 200 000 infeksionesh në fillim të janarit, por tani ka rënë në më pak se gjysmën e tij.

Relaksimi i ardhshëm thuhet se do të jetë pjesë e planeve të Johnsonit për ta rifituar postin e tij të kryeministrit ndërsa ai lufton me një mori akuzash për festat pavarësisht prej masave kufizuese, ose aferën "partygate" në Downing Street.

Udhëheqësi i Partisë Laburiste të opozitës, Keir Starmer, ra dakord me nevojën për t'i hequr kufizimet "sa më shpejt të jetë e mundur" nëse shkencëtarët e qeverisë bien dakord, por vuri në dukje sfondin e skandalit politik.

"Unë dua që ato të hiqen sepse shkenca mjekësore thotë se ato duhet të hiqen, jo thjesht sepse kryeministri është në një rrëmujë të vërtetë dhe ai po përpjet dëshpërimisht të dalë prej saj", tha ai për BBC.

Shumë deputetë konservatorë janë të shqetësuar për raportet e thyerjes së rregullave në Downing Street dhe tashmë e kishin paralajmëruar Johnsonin se nuk mund të llogarisë në mbështetjen e tyre për t'i zgatur kufizimet kundër Covid-19.

Duke u përballesh me mbështetësit e shqetësuar të konservatorëve, kryeministri kundërshtoi thirrjet e disa shkencëtarëve për të vendosur një bllokim të plotë në dhjetor dhe lejoi që ngjarjet sportive të vazhdojnë me turma në Angli.

Vazhdon shtimi i rasteve me Covid në Kosovë, bëhet thirrje për respektim të masave

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të dielën, më 16 janar, janë regjistruar 771 raste të reja me koronavirus pas testimit të 6 mijë e 553 mostrave. Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 11.76 për qind.

Në 24 orët e fundit nuk është regjistruar asnjë vdekje nga Covid-19.

Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar edhe se 119 persona janë shëruar derisa 4 489 persona janë ende raste aktive me koronavirus.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës.

Qytetarët në Kosovë mund të marrin vaksina të kompanive "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca". Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës janë të shtrirë 72 pacientë, prej tyre 43 pacientë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 29 të tjerë post-Covid. Me oksigjeno-terapi janë 38 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës

Infektive janë të shtrirë 3 pacientë.

IKShPK-ja: Omicroni po shton intensitetin çdo ditë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Omicroni po shton intensitetin çdo ditë dhe është varianti dominues në qarkullim. "Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK apelon të të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka njoftuar ky institut.

IKShPK-ja ka theksuar se është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoren maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. "Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje për kujdes dhe mosgrumbullim. U rekomandojmë institucioneve përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për



parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Komuna e Prishtinës furnizon shkollat me teste antigjen

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të pandemisë, komuna e Prishtinës për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të shkollës është duke bërë furnizimin me teste të shpejta

antigen përmes pështymës për Covid-19. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se shpërndarja e testeve ka filluar të bëhet nëpër institucione dhe gjatë pranimit të produktit ekipi i kontraktuar do t'ju japë informatat e hollësishme dhe do të ofrojë trajnim rreth përdorimit të testeve antigjen. "Deri më tani testet antigen janë shpërndarë nëpër tetë institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme të larta, kryesisht me numër të madh të nxënësve

në zonat urbane. Në ditët në vijim mbetet të përfshihen edhe zonat periferike të kryeqytetit. Është planifikuar që testet të shërbejnë gjatë gjithë gjysmëvjetorit të dytë. Do të testohen vetëm nxënësit që kanë këto simptoma: Temperaturë mbi normale, kollitje apo ethe dhe kontakt me persona të infektuar. Ndarja e testeve është bërë në proporcion me numrin e nxënësve në institucione", ka njoftuar komuna e Prishtinës.

Shqipëri, katër të vdekur dhe rreth 1 700 raste të reja me Covid



TIRANË, 16 JANAR - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë kryer 5 280 testime nga të cilat 1 697 persona kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Ndërkohë, në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë 4 qytetarë të prekur me Covid-19, ndërsa 935 janë shëruar. Aktualisht në spitalet Covid po marrin trajtim 148 pacientë, nga të cilët 15 janë në gjendje më të rënduar. "Ministria e Shëndetësisë u bën apel qytetarëve të vaksinohen sa më

parë për ta mbrojtur veten dhe shëndetin e të tjerëve. Çdo qytetar mbi 16 vjeç mund të vaksinohet në qendrën shëndetësore ose në pikën më të afërt të vaksinimit të përqendruar. Vaksinimi është i hapur edhe për fëmijët +12 vjeç me probleme të sistemit imunitar, me rekomandim nga mjeku. MShMS u bën thirrje qytetarëve që kanë kaluar 6 muaj nga marrja e dozës së dytë të vaksinës, të drejtohen në qendrat shëndetësore ose pikat e vaksinimit të përqendruar, për t'u

vaksinuar me dozën e tretë përforcuese", ka bërë me dije kjo ministri.

Ministria e Shëndetësisë ua kujton qytetarëve se respektimi i protokolleve kundër Covidit është domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit. "Vendosja e maskës është e detyrueshme në çdo ambient të mbyllur. Shmangni grumbullimet dhe ajrosni ambientet ku qëndroni për ta kufizuar përhapjen e Covid-19", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri.


Reçica: PDK-ja do të formojë nëndegë në të gjitha qytetet ku jetojnë shqiptarët në Zvicër

PRISHTINË, 16 JANAR - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Elmi Reçica, njëherësh edhe udhëheqës i Departamentit të Diasporës nga kjo parti, gjatë qëndrimit në Zvicër, tha se do të formohen nëndegët e PDK-së në të gjitha qytetet ku jetojnë shqiptarët në Zvicër. Përmes

një shkrimi në "Facebook", Reçica tha se Partia Demokratike ka filluar angazhimin për formimin e nëndegëve të saj kudo ku jetojnë shqiptarët në diasporë. "Kënaqësi e jashtëzakonshme takimi me qytetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në diasporë, por gjithmonë me mendje e zemër janë pranë

vendlindjes. Me kërkesë të qytetarëve tanë në diasporë dhe me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve të përbashkëta për forcimin dhe zhvillimin e vendit, Partia Demokratike e Kosovës ka filluar angazhimin për formimin e nëndegëve të saj kudo ku jetojnë shqiptarët në diasporë", ka thënë ai.





Kosova ndaloi referendumin e Serbisë

Republika e Kosovës përmes një rezolute të miratuar nga deputetët në Kuvendin e Kosovës ka ndaluar referendumin e Serbisë, i paralajmëruar se do të mbahet në disa komuna me shumicë serbe në territorin tonë më 16 janar. Ky vendim nuk u ka pëlqyer qytetarëve serbë të cilët të dielën janë mbledhur në qendër të Mitrovicës së Veriut dhe kanë protestuar kundër vendimit të autoriteteve të Kosovës për të mos lejuar referendumin serb në Kosovë. Votuesit serbë janë detyruar të votojnë në vendvotimet në Kurshumli, Novi Pazar, Rashkë dhe Vranjë, qytete këto që ndodhen afër kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 16 JANAR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës të shtunën kanë miratuar një rezolutë që shpreh kundërshtimin që në Kosovë të mbahen votime për një referendum të shtetit të Serbisë për ndryshime kushtetuese. Me 76 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rezolutën në një seancë të jashtëzakonshme të thirrur nga

kryeministri Albin Kurti. Sipas rezolutës, mbajtja e referendumin të Serbisë në Republikën e Kosovës “cenon sovranitetin dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, është në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet e Republikës së Kosovës si dhe me normat e praktikat ndërkombëtare”.

Rezoluta u propozua nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Grupit Multientik. Partia Demokratike në opozitë nuk mori pjesë në seancë.

Rezolutat e miratuara nga kuvendi nuk janë detyruese, por pasqyrojnë vullnetin politik.

Disa serbë të Kosovës, kryesisht të punësuar në institucionet publike të financuara nga Serbia, u mbledhën në qendër të Mitrovicës së Veriut të dielën për të protestuar kundër vendimit të autoriteteve të Kosovës për të mos lejuar një referendum serb

në Kosovë.

Protesta u mbajtën edhe në disa komuna të tjera me shumicë serbe në Kosovë.

Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, tha në protestë se serbët do të votojnë në zgjedhjet e shpallura nga Serbia më 3 prill dhe paralajmëroi vendosjen e reciprocitetit me Prishtinën.

Rakiq i bëri thirrje Bashkimit Evropian, shteteve të Quintit dhe aktorëve të tjerë

ndërkombëtarë, që “t’u japin serbëve në Kosovë të drejtën e votës”.

Ai tha se serbët nga Kosova nuk do të “lejojnë që Prishtina t’i trajtojë ata si qytetarë të dorës së dytë”, duke theksuar se e drejta e votës është një e drejtë themelore e njeriut e garantuar me të gjitha normat dhe rregulloret ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. “Për këtë arsye ne tani po themi se zgjedhjet serbe më 3 prill do të mbahen në të gjitha sferat në Kosovë”, tha Rakiq, duke shtuar se serbët nga Kosova janë të përkushtuar për një jetë të qetë dhe normale në liri. “Ne paralajmërojmë Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar se vendimi për ndalimin e referendumin do të

ketë pasojë të paparashikueshme”, tha Rakiq. Të tubuarit mbanin pankarta: “Po për të ardhmen, jo për konflikte”, “Po liri, jo jetë në skllavëri”, “Edhe serbët kanë të drejta të njeriut”.

Në një seancë të mbajtur më 15 janar, anëtarët e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve të Serbisë (KRE) vendosën për mënyrën se si votuesit kosovarë do të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në referendum për të konfirmuar Aktin për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Serbisë, e planifikuar për 16 janar.

Kryetari i KQZ-së, Vladimir Dimitrijevic, tha se votuesit nga Kosova do të mund të votojnë në vendvotimet në Kurshumli, Novi Pazar, Rashkë dhe Vranjë. Bëhet fjalë për qytete që ndodhen afër kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Emrat e votuesve nga Kosova do t'u shtohen gjithsej 45 vendvotimeve, ka konfirmuar Dimitrijevic.

Transporti nga komunitetet serbe në Kosovë është organizuar dhe qytetarët kanë votuar në grup.

Konsensusi i pozitës dhe opozitës kundër referendumit

Pas miratimit të rezolutës nga ana e Kuvendit, ka reaguar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke thënë se përhëndet konsensusin mes grupeve parlamentare për votimin e kësaj rezolute.

Qeveria e Kosovës ka

kundërshtuar mbajtjen e referendumit të Serbisë në territorin e Kosovës duke e quajtur shkelje të rendit kushtetues të Kosovës.

Kundërshtime lidhur me këtë qëndrim pati nga shtetet e Quintit.

Në hapje të seancës së Kuvendit të Kosovës, kryeministri Albin Kurti tha se nuk është kundër të drejtës së votës së qytetarëve serbë kosovarë me dy shtetësi duke thënë se votimi mund të bëhet në Zyrën Ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë. Ai e ka kundërshtuar idenë që Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) t'i grumbullojë votat në Kosovë për referendumin në Serbi. “Një praktikë e gabuar e vendosur nëpër vite nuk e arsyeton vazhdimin e gabimit të njëjtë. Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe duhet të trajtohet si e tillë”, tha Kurti.

Në këtë seancë, Lumir Abdixhiku, kryetar i partisë opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, ka ritheksuar qëndrimin e partisë së tij kundër referendumit të Serbisë në Kosovë. “Për LDK-në mbajtja e referendumit të një shteti tjetër është çështje e mbyllur para se të nisë. LDK pret, mirëpret dhe mbështet respektimin e plotë të Kushtetutës dhe rendit tonë kushtetues”, tha ai.

Megjithatë, Abdixhiku e kritikoi kryeministrin Kurti lidhur me thirrjen e seancës duke e quajtur të panevojshme dhe tentativë për t'u fshehur pas deputetëve. “E paqartë mbetet

mbajtja e kësaj seance dhe nxjerrja e një rezolute për rekomandim ndaj qeverisë. Kushtetutën e ke, ushtro rolin kushtetues prej kryeministrit”, tha ai.

Kundërshtimin ndaj referendumit të Serbisë në Kosovë e shprehu edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Në anën tjetër, kryetari i grupit parlamentar i Listës Serbe, Igor Simiq, bëri thirrje që të ndërpritet “fushata anti-serbe” dhe të lejohet mbajtja e referendumit serb.

Lista Serbe është partia kryesore serbe e Kosovës dhe ka mbështetjen e Beogradit zyrtar. “Edhe një herë nga ky vend, në emrin tim personal dhe në emër të Listës Serbe, popullit serb, ju ftojme ta ndryshoni vendimin tuaj dhe të mundësoni referendumin në përputhje me parimet aktuale. Kjo është një thirrje për arsye, një thirrje për përgjegjësi, që të fillojmë ta respektojmë popullin tonë dhe të drejtat e tyre themelore njerëzore”, tha Simiq.

Pas fjalës së Simiqit, deputetët e Listës Serbe u larguan nga salla e Kuvendit me arsyetimin se “nuk duan t'i japin legjitimitet seancës”.

Të premtën, më 14 janar, zyrtarë të Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian kanë thënë se me keqardhje kanë pranuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për të mos e lejuar Organizatën për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që të grumbullojë votat në Kosovë për referendumin në Serbi. “Ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i lejojë serbët në Kosovë ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në zgjedhje dhe procese zgjedhore në përputhje me këtë praktikë të vendosur”, është thënë në deklaratë.

Komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia që të mos rritin tensionet lidhur me referendumin të cilin e kanë cilësuar si “hap kyç për ta forcuar pavarësinë e gjyqësorit” dhe për ta rritur transparencën e institucioneve të shtetit dhe sundimit të ligjit. “I bëjmë thirrje qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë që të përmbahen nga veprimet dhe retorika që rritin tensionet dhe të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Është e rëndësishme që të dyja qeveritë të arrijnë progres drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse që hap perspektivën e BE-së dhe rrit stabilitetin rajonal”, është thënë në reagim.

Institucionet e Kosovës kanë thënë të premtën se hapja e qendrave të votimit të Serbisë në Kosovë përbën shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës.

Udhëheqësi i Presidencës, ai i Qeverisë dhe i Kuvendit të Kosovës kanë dalë me deklaratë të përbashkët pas takimit me zyrtarët e vendeve të Quintit dhe Zyrën e Bashkimit Evropian

në Kosovë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 13 janar se votimi në referendumin e një shteti tjetër, në një territor sovran, “nuk është praktikë e pranueshme nga asnjë shtet demokratik”. Ai ka thënë se serbët në Kosovë me shtetësi të dyfishtë mund të votojnë në referendumin e Serbisë përmes postës apo në Zyrën Ndërlidhëse në Prishtinë.

Policia e Kosovës një ditë më parë ka ndaluar futjen e materialit zgjedhor për referendumin serb në Kosovë. Sipas njoftimit, më 14 janar, në kufirin Kosovë - Serbi, në Merdar, kanë ardhur tri automjete (një veturë dhe dy kamionë) me targa të Serbisë, në të cilat kanë qenë gjashtë persona. Këto automjete, sipas policisë, kanë bartur material që dyshohej se do të përdoret për referendumin që pritet të mbahet në Serbi më 16 janar.

Në ndërkohë, misioni i OSBE-ja ka deklaruar se kishte qenë i gatshëm të kryente një operacion për mbledhjen e votave në përputhje me precedentin e mëparshëm dhe me pëlqimin e të gjitha institucioneve përkatëse. “Në mungesë të pëlqimit të nevojshëm, siç është bërë e qartë në deklaratat e mëparshme, dhe siç u është komunikuar të gjitha palëve, nuk ka rezultuar e mundur që Misioni të kryejë një operacion të tillë me këtë rast”, thuhet në deklaratën e OSBE-së në “Facebook”.



Policia gjatë një aksioni kapi mbi pesë kilogramë drogë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 JANAR - Të dielën rreth orës 07:20 Policia e Kosovës, konkretisht Sektori Qendror për Hetimin e Narkotikëve-DHTN, pas pranimi të informatave përmes rrugëve operative, se disa persona (me veturë) janë duke transportuar substancë të dyshuar narkotike, kanë realizuar një plan taktik në koordinim me patrullën policore të Stacionit Policor të Novobërdës dhe në udhëkryqin Novobërdë - Gjilan, në fshatin Llabjan, kanë tentuar ta ndalojnë veturën e dyshuar "Pollo" me targa vendore. Gjatë këtij tentimi për ta ndaluar veturën e dyshuar të cekur më lart, personat e dyshuar në veturë, duke mos iu bindur urdhrave të zyrtarëve policorë, kanë ikur me shpejtësi nga ai

lokacion dhe policia menjëherë është aktivizuar për ndjekjen e tyre. "Pas rreth një kilometër (1 km) nga lokacioni fillestar, zyrtarët policorë kanë arritur ta ndalojnë veturën e dyshuar ku edhe është arrestuar një person, kurse personi tjetër ka arritur të largohet duke tentuar që edhe substancën narkotike ta marrë me vete. Gjatë ndjekjes nga policia, i dyshuari e ka hedhur substancën narkotike, me ç'rast janë konfiskuar 5 kg e 185 gr substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, vetura e dyshuar dhe shuma e parave prej 925.00 eurosh", ka njoftuar policia. Antidroga e Policisë në këtë rast është mbështetur edhe nga patrulla policore Novobërdë, Njësi K9, Forenzika regjionale Gjilan dhe patrulla policore e stacionit veri në Prishtinë. Dëshmitë relevante janë fotografuar dhe janë tërhequr



nga njësi i Krim Teknikës-Gjilan. "Personit të dyshuar, tanimë i arrestuar, i është

caktuar masa e ndalimit, përdërisa edhe një person tjetër i dyshuar për rastin ndodhet në

arrati dhe është në kërkim nga autoritetet policore", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Ambasadori amerikan në Reçak: Të mos mohohet çfarë ka ndodhur këtu



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë mori pjesë të shtunën (15 janar) në ceremoninë e përkujtimit të Masakrës së Reçakut. Në organizimin ku morën pjesë edhe liderët shtetërorë të Kosovës, ambasadori Jeffrey Hovenier tha se "pranimi i të vërtetës së të kaluarës është vetëm hapi i parë kah drejtësia". "Askush të mos harrojë ose mohojë se çka ndodhi këtu ose përse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

aleatët tanë u ngritën në mbrojtje të popullit të Kosovës", tha Hovenier. Ai shtoi se dëshiron të jetë i qartë për përkushtimin e Shteteve të Bashkuara ndaj të vërtetës. Hovenier citoi ish-presidentin e ShBA-së, Bill Clinton, që në atë kohë kishte thënë: "Ishte një akt vrasës i qëllimshëm dhe pa dallim që synonte të mbillte frikë te populli i Kosovës". Më 15 janar të vitit 1999 forcat policore dhe ushtarake serbe në Kosovë vranë 45 civilë shqiptarë në fshatin Reçak në

komunën e Shtimes. Krimet e kryera në këtë fshat i kishte dokumentuar kreu i atëhershëm i misionit vëzhgues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, William Walker. Ngjarja e Reçakut u pasua nga bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe në Kosovë si dhe në Serbi. Vullin ka mohuar disa herë në të kaluarën masakrën e Reçakut, duke e quajtur këtë masakër si një "krim të fabrikuar".

Ndalimi i mbajtjes së referendumit serb, Tërmkollli: Fitore domethënëse për Kosovën, me Kurtin e Osmanin

PRISHTINË, 16 JANAR - Ish-deputetja e LDK-së, Melihate Tërmkollli, e ka quajtur fitore të vendit me kryeministrin Albin Kurti dhe presidenten Vjosa Osmani, mosmbajtjen e referendumit serb në Kosovë.

Ajo përmes një postimi në "Facebook" ka shkruar se tani Serbia duhet të mësohet që ta respektojë e pranojë Kosovën shtet. "Një fitore domethënëse për Kosovën, me kryeministrin Kurti dhe presidenten Osmani.

Është ditur gjithnjë dhe tani po provohet se duhet të mësohet Serbia ta respektojë e pranojë Kosovën shtet. Kur ne veprojmë e tregojmë që jemi shtet, në raport me çdokënd", ka shkruar Tërmkollli.



BQK-ja merr pjesë në takimet e konstituencës në Budapest



PRISHTINË, 16 JANAR - Zëvendësgubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Sokol Havolli, mori pjesë në takimet e konstituencës në Budapest të Hungarisë për të negociuar lidhur me marrëveshjen e konstituencës së FMN-së për 10 vitet e ardhshme në të cilën bën pjesë Kosova. Rezultatet e negociatave

gjetën mbështetje nga të gjithë anëtarët e konstituencës. Anëtarët u pajtuan që përbërja e kësaj konstituence edhe për 10 vitet e ardhshme të vazhdojë të jetë e njëjtë me anëtarët e deritanishëm si: Austria, Bjellorusia, Republika Çeke, Hungaria, Kosova, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia. Në kuadër të këtij takimi

vendet anëtare u pajtuan edhe për ndarjen e pozitave të përfaqësimit të këtyre vendeve në zyrën e drejtorit ekzekutiv të konstituencës, me ç'rast Kosovës iu alokua pozita e këshilltares për katër vjet. Marrëveshja finale pritet të nënshkruhet nga guvernatori Fehmi Mehmeti gjatë takimeve pranverore të FMN-së në Uashington.

Çfarë po bën Evropa për ta zgjidhur krizën me gaz?



PRISHTINË, 16 JANAR - Kriza me gaz natyror po vazhdon në Evropë. Rezervat janë të ulëta dhe çmimet janë të larta e konsumatorët po përballen me fatura të shtrenjta të shërbimeve. Furnizuesi kryesor rus, Gazprom, nuk po shet gaz siç shiste më parë.

E gjithë kjo situatë ngrit pyetjen: Si Evropa, që importon shumicën e energjisë, do t'ia dalë që gjatë dimrit ta shmangë katastrofën me gaz, veçanërisht nëse sezoni i dimrit është më i ftohtë apo më i gjatë se zakonisht?

Kompanitë që shesin gaz u drejtohen depove ku ruhet gazi, që zakonisht janë depo nëntokësore, me qëllim që të mund t'i bëjnë ballë kërkesës shtesë për gaz që përdoret për ngrohje apo për elektricitet. Evropa e nisi vitin 2021 me depot e mbushura me gaz vetëm 56 për qind të kapacitetit, krahasuar me 73 për qind të një viti më parë.

Arsyet e mungesës së rezervave variojnë: dimri i kaluar ishte shumë i ftohtë, mungesa e dërgesave ruse në treg dhe kërkesa e madhe në Azi për gaz të lëngshëm natyror, që transportohet përmes anijeve. Shoqata Evropiane e Operatorëve të Tubacioneve të Gazit tha se moti i ftohtë do të nënkuptojë se do të duhen të importohen 5 deri në 10 për qind më shumë gaz sesa

vëllimet maksimale të blera në vitet e fundit me qëllim që të shmangët kriza që do të çonte në mbyllje të bizneseve.

Në Evropë çmimi standard për një megavat në orë është rreth 80 euro, apo katërfish më i lartë sesa në fillim të vitit 2021 kur kushtonte 19 euro, ndërkaq më 2020 çmimi për një megavat kishte qenë 4 euro. Çmimet janë ulur plot nëntë herë që prej fillimit të vitit të kaluar. Por, rritja e çmimeve ka ndikuar në rritjen e faturave, duke alarmuar konsumatorët dhe politikanët.

Analistët në Rystad Energy përdorën të dhënat nga gjurmimi i anijeve muajin e kaluar dhe panë 11 cisterna që sillnin gaz të lëngshëm natyror në Azi dhe më pas ktheheshin në mes të oqeanit për të përfituar nga shitjet përfituese në Evropë. Me çmime kaq të larta, tregtarët u tunduan që t'i devijonin ngarkesat për në Evropë edhe nëse do të duhej të ofronin 100 për qind të çmimit si kompensim, thanë analistët në kompaninë e të dhënave, Energy Intelligence.

“Nuk do të thosha se gazi i lëngshëm natyror është 100 për qind i mjaftueshëm, por do të luajë një rol të rëndësishëm” në zgjidhjen e problemit të energjisë të Evropës, tha Xi Nan, shefe për tregjet me gaz të lëngshëm natyror në Rystad. Ajo paralajmëroi se kjo varet “se sa shumë Evropa është e gatshme

të paguajë” për gaz.

Kompania shtetërore ruse Gazprom po shet më pak gaz përmes kontratave afatshkurta përmes tubacionit që kalon nëpër Poloni dhe Ukrainë. Por, Gazprom nuk ka mbushur depot evropiane me gaz siç bën zakonisht, edhe pse duket se po zbaton të gjithat kontratat afatgjata.

Analistët besojnë se Rusia ndoshta kështu po shpreh dëshirën e saj që Evropa të miratojë lëshimin në përdorim të gazsjellësit rus në Gjermani, “Rrjedha Veriore 2”, tubacion që anashkalon Poloninë dhe Ukrainën. Por, në këtë kohë tensionet janë rritur midis Evropës dhe Rusisë për shkak të grumbullimit të mijëra trupave ruse në afërsi të kufirit me Ukrainën.

Moti në Evropë dhe Azi deri më tani ka qenë relativisht i butë dhe më shumë gaz i lëngshëm është duke ardhur. Por, rritja e çmimeve ka detyruar industrinë që të përdorin më pak gaz, duke shkurtuar prodhimin. Ndërkaq, Norvegjia, që është një prej furnizuesve të Evropës, ka rritur dërgesat e gazit. “Kjo do të thotë se mund ta kalojmë këtë dimër me dërgesat ruse, sado të vogla të jenë ato”, tha James Huckstepp, menaxher për Evropën, Lindjen e Mesme dhe Afrikën në kompaninë që merret me analiza të energjisë, S&P Global Platts. “Nuk mund të

them se kriza është tejkaluar sepse ende ka rrezik që temperaturat të bien dhe ka shumë pak gaz nëpër depo”.

Nëse ka ngrica të papritura “do të kemi skenarë më ekstremë dhe do të detyrohemi ta kufizojmë përdorimin e gazit dhe kjo gjë do të fillonte nga industrinë, por edhe konsumatorët janë në rrezik”, tha Huckstepp.

Qeveritë evropiane po ofrojnë subvencione me para të gatshme për konsumatorët, me qëllim që ta zbutin krizën.

Suedia javën e kaluar njoftoi se do të ofronte 661 milionë dollarë për familjet më të prekura nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike.

Zgjidhja qëndron në investimin më të madh në energjinë e ripërtërishme siç është prodhimi i energjisë përmes erës dhe paneleve diellore. Por, zyrtarët kanë pranuar se gazi do të luajë rol kyç në vitet e ardhshme derisa të ndodhë tranzicioni në energji të ripërtërishme.

Kazakistani, shtet i pasur me resurse, e furnizon Bashkimin Evropian me naftë, por jo me gaz dhe dërgesat e naftës janë penguar nga protestat e dhunshme që u nxitën pas rritjes së çmimeve të karburanteve. Protestat më pas u reflektuan edhe në pakënaqësitë e mëdha të publikut ndaj Qeverisë autoritare të Kazakistanit.

Sipas legjislacionit të BE-së,

shtetet anëtare duhet ta ndihmojnë njëra-tjetrën kurdo që ka mungesa të gazit. Qeveritë mund të shpallin gjendje emergjente për shkak të mungesës së gazit dhe mund t'i mbyllin industrinë me qëllim që gazi të shkojë për qytetarët. Një gjë e tillë do ta dëmtonte ekonominë, por do ta shmangte një fatkeqësi humanitare dhe politike.

Në teori kjo gjë do të kërkonte që dërgesat e gazit të kalonin kufijtë shtetërorë të shteteve anëtare të bllokut evropian. Në vitet e fundit Evropa ka ndërtuar lidhje të tubacioneve, por ato nuk janë të mjaftueshme për ta mbuluar të gjithë kontinentin, duke lënë disa shtete më të ekspozuara ndaj mungesës së gazit.

Megjithatë, ky sistem i shpërndarjes së gazit nuk është testuar më parë dhe ka pikëpyetje lidhur me atë se sa shtetet do të kenë vullnet që ta ndajnë gazin gjatë krizave. Komisioni Evropian po punon për t'i rishikuar rregullat ku përfshihet edhe blerja e përbashkët e gazit, sipas vullnetit të lirë të shteteve anëtare, tha Ruven C. Fleming, një avokat për energjinë dhe profesor në Universitetin Groningen të Holandës. Shqyrtimi i rregullave “është tregues i qartë se edhe nëse instalohen të gjitha mekanizmat, nuk mendoj se do të funksionojnë aq mirë”, tha Fleming. (Rel)

Misteri afrikan: Pse Covid-19 ka shkaktuar më pak vdekje se kudo tjetër?



Nga Federico GIULIANI
"Il Giornale"

Është një kontinent i madh, rreth 7 herë më i madh sesa Bashkimi Evropian, dhe i banuar nga pothuajse 1.5 miliardë njerëz, pa llogaritur këtu shumë të tjerë që nuk figurojnë në regjistrat zyrtarë. Me përjashtime të rralla, është gjithashtu një rajon i përbërë nga shtete të varfra, apo në çdo rast pa sisteme ekonomike, politike dhe shëndetësore, që të përballojnë si duhet sfidat e shekullit XXI-të.

Por pavarësisht gjithë kësaj, deri më tani Afrika e ka kaluar shumë mirë testin Covid-19. Pandemia e Sars-Cov-2, që ka shkaktuar shumë të vdekur dhe tmerr në çdo cep të botës, këtu duket se ka ngecur që në hyrje. Më lejoni të jem i qartë: Edhe popullatat afrikane kanë pasur humbjet e tyre, edhe atje është ndërprerë puna në fazat më kritike të pandemisë, për të zbatuar bllokime apo masa të

ashpra kufizuese.

Megjithatë, shifrat epidemiologjike të Afrikës, janë qartësisht më pozitive se të dhënat e mbledhura nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian; si për sa i përket infeksioneve, ashtu edhe numri të viktimave. Si të mos mjaftonte kjo, dy nga variantet e fundit që po vazhdojnë të mbajë botën në ankth, janë regjistruar zyrtarisht në vendet afrikane.

I fundit prej tyre, Omicron, është identifikuar së pari në Afrikën e Jugut, dhe ka detyruar disa vende evropiane që të rivendosin masa e ashpra kufizuese. Përkundrazi, institucionet e Afrikës së Jugut, të cilat sigurisht që nuk shkëlqejnë për shkallën e vaksinimit të popullatës – deri më sot kanë arritur të vaksinonjë plotësisht vetëm 27 për qind të popullsisë – e pranuan se Omicron ishte më ngjithës por jo më vdekjeprurëse, ndaj e panë të arsyeshme të lehtësonin masat.

Në veçanti, pati një rënie të ndjeshme të shtrimeve në spitalin "Steve Biko Academic Hospital" në Tshuane, ku u identifikua për herë të parë mutacioni i ri. Vdekshmëria ishte pothuajse sa 1/5 e varianteve të mëparshme, duke konfirmuar atë që disa ekspertë e dyshuan që në fillim.

Në kulmin e valës Omicron, që me sa duket në Afrikën e Jugut po mbaron, numri i shtretërve të zënë nga pacientët e infektuar, ishte sa gjysma e asaj të periudhës së mëparshme. 63 për qind e pacientëve me Omicron u shtruan në spital për arsye të tjera, dhe virusi u zbulua vetëm nga testet e detyrueshme.

"Epidemia e Omicron, është përhapur dhe ka rënë me shpejtësi të paparë, duke arritur kulmin brenda 4 javësh"- thanë studiuesit, që nënvizuan se rezultatet mund të ndryshojnë në vende me tipare të popullsisë dhe me nivele imuniteti të ndryshme, përveç numrit të infeksioneve dhe të

vaksinimeve.

Por e sigurt është se Afrika e Jugut, dhe Afrika në përgjithësi, po i mësojnë botës se si të përballen me një pandemi, duke përdorur mjetet më të mira në dispozicion, dhe pa rënë pre e histerisë kolektive. Po cili është sekret i Afrikës? Tek e fundit po flasim për një kontinent të varfër, me probleme të të gjitha llojeve, dhe të cilit i mungojnë shumë komoditete mbi të cilat mund të mbështetet Perëndimi, para së gjithash vaksinat kundër Covid-19.

Në fakt rajoni afrikan, ka pasur qasje në shumë pak doza vaksine, dhe shumica e popullsisë është e ekspozuar ndaj efekteve të virusit. E megjithatë, masakra e Sars-CoV-2 në Afrikën Sub-Sahariane e shpallur praktikisht që nga fillimi i pandemisë, nuk ndodhi kurrë. Përkundrazi, duke lexuar buletinet, më shumë vdekje raportohen në Itali ose Francë sesa në disa nga vendet më të varfra (dhe më pak të vaksinuara) në botë. Kështu

Italia ka aktualisht 229 të vdekur për 100 mijë banorë, ndërsa Uganda 7 për 100 mijë, dhe Nigeria vetëm 2 në 100 mijë banorë.

Është e vështirë që ky paradoks të shpjegohet me formula dhe siguri matematikore. Në këto kushte mundet vetëm të spekulojmë. Dhe komuniteti shkencor spekulon se pavarësisht nga vaksinat e pakta, faktori moshë, mund të ketë ndihmuar në shmangien e qindra viktimave.

Pra, mosha mesatare shumë e re e popullsisë afrikane, duhet të ketë frenuar efektet më negative të Covid-19. Pastaj ka një shpjegim tjetër të mundshëm. Disa shkencëtarë pretendojnë se vendet më të ekspozuara ndaj sëmundjes së malarisë, mund të kenë zhvilluar disa forma imuniteti kundër Sars-CoV-2 tek qytetarët e tyre. Në çdo rast, dhe madje duke marrë parasysh dhe dallimet themelore, të paktën një herë Perëndimi duhet të fillojë të marrë shembull nga Afrika. / Il Giornale – Bota.al

Në 'bibliotekën' e Migjenit

Nga: Lazër RADI

Nji mbas nji, ditët nisën me hy n'at rrjedhën e zakonshme.

Mbasditeve kur Milloshi s'ishte në mësim, të shtunave o të dielave që ishte i lirë, ai ishte i ftuem në Nënprefekturë për ndonji "seancë" loje. Mungesën e tij, unë e mbushja duke lexue librat e bibliotekës së tij.

Siç ma kishte theksue edhe netë ma parë, kisha qëllue me fat pse e njifsha mirë serbokroatishten, dhe pjesa ma e madhe e librave, mos me thanë krejt, ishin n'at gjuhë.

S'di se ç'libra kishte Milloshi në Shkodër, po në Pukë kishte pak, po të zgjedhun. Pjesa ma e madhe e tyne, e theksoj ishin të edicionit NO-LIT (Nova Literaturnaja), që botonte kryesisht vepra dhe shkrimtarë bashkëkohorë, të cilët trajtonin probleme të mprehta sociale. Ishin vepra moderne me frymë realiste, të cilat Milloshi i kish lexue e stërlxue. Ndodhte që pasazhe të tana prej atyne veprave m'i tregonte si ta kishte librin përpara ...

Nji ditë ndërsa flisnim për këto botime më tha: Formimim tim kulturor e pata kryesisht gjatë periudhës së seminarit. Mësimet fetare, liturgjitë e përgjithsisht atmosfera e seminarit ma merrte frymën. Gjithnji e ma tepër e ndjeja vetminë mbytëse, e kët gjendje shpirtnisht të rrezikshme, nisa me e mujtë vetëm me lexime. Edhe unë, në fillim isha kështu si ti: s'kisha fort preferenca. Lexoja ç'ka m'binte në dorë. Shën Agostinin, edhe pse s'e kisha në landët mësimore, më pëlqente shumë si filozof dhe e lexoja me andje të veçantë.

Nga vepra e tij "Omnia", jam përpjekë me mbledhë, si ajo blea punëtore, pjesën ma të shëndoshë, at nektar që mendoja se do t'më shërbente për formimin tim intelektual e pozitiv. Shpesh e pyesja vedin: "Ç'asht e vërteta?! A besohet në t'vërtetën?" Kësaj pyetje të dyfishtë, pikrisht te Shën Agostini e kam gjetë përgjegjen: "E vërteta asht e vërtetë, vetëm kur përputhet me realitetin e deri në çastin kur ajo mbetet objektive", mirëpo mendimi njerzor asht gjithmonë subjektiv e, për pasojë, vetëm tue reflektue përmes këtij subjektivizmi njeriu ka mujtë me e zbulue përmbytjen e së vërtetës!"

"Po dyshimi çfarë asht?" Pra, kur dyshojmë, dyshojmë veç kur bajmë nji krahasim të mendimit personal me nji të vërtetë objektive? Me fjalë të

tjera unë s'mundem me dyshue në dyshimin tim d.m.th. ne, si njerëz, jemi të sigurt se ekzistojmë vetëm pse jemi njikohësisht qenie menduese dhe dyshuese.

Nga pak e përditë, Milloshi kishte nisë me m'futë thellë e ma thellë labirintheve të filozofisë. Biseda më pëlqente, më joshte. Edhe pse shumë gjana s'arrija me i kuptue mirë, s'doja me e ndalë njet rrjedhë të tij gufuese. Asokohe, kisha nisë me marrë njifarë njoftje mbi filozofinë e Dekartit: "Unë mendoj, pra unë jam". Por, ajo ç'ka po më shpjegonte Milloshi ishte diçka krejt tjetër! N'ato çaste as unë s'dëshiroja me e ba habitshëm rolin e nxanësit. Si duket ai e nuhati kët gjendje timen dhe vazhdoi:

– Bashkë me Shën Agostinin kam lexue me etje edhe Niçen, pa harrue "Vllaznit Karamazov" të Dostojevskit, që për mue asht ndër shkrimtarët ma të mëdhej të kësaj bote. Edhe "Martin Iden" i Xhek Londonit asht ndër librat ma interesantë të kohës sonë. Në seminar, interesohesha fort për rrymat dhe drejtimet letrare që po përhapeshin me shpejtsi nëpër botë. Kureshtja shpesh më shtynte me depërtue përtej "Kordonit të hekurit", ku mund të gjeja e të njifja "prozën dhe poezinë e re ruse", n'Veçanti Majakovskin dhe revolucionin e tij poetik, për të cilin aq shumë flitet në shtypin jugosllav të kohës. Mundem me thanë se i kam stërlxue dhe i kam ndje thellë shpirtnisht "Kangët" e Branko Radiçevićit, poetit të rinisë serbe, që vdiq nga ftizia në moshën 29 vjeçare. Shumë më ka pëlqye edhe poeti bohem kroat Tin Ujeviç; me pasion kam lexue Miroslav Kërlezhen, në veçanti dramën e tij të famshme "Gospoda Glembajev" (Zotnia Glembajev).

Prej çdo bisede me Milloshin mësoja gjana të reja dhe interesante. Po ma e randsishmja për mue, qe ajo përzgjedhje librash që ai kishte bërë. Libra me përmbytje të thellë shoqnore e me pikpamje filozofike kontemporane. Kështu edhe unë po futesha si pa u ndje në hapsinën e shijeve migjeniane, n'at terren ku hap mbas hapi plotsohej vepra e tij.

Për librat që kishte në Pukë, Milloshi më shpjegoi se gjithçka kishte aty, e që mund t'i lexoja gjatë asaj vere, ai i kishte lexue, megjithatë ai shpesh u rikthehej me kënaqsi rileximeve e u hidhte nji sy shënimeve të shumta me laps,



e nënvizimeve që gjindeshin pothuaj në çdo faqe.

Kur fliste për librat e merrte nji entuziazëm i çuditshëm. Ndodhte shpesh të komentonte episode nga ma të ndryshmet, të cilat i konsideronte mjaft interesante. Ndigjoja përmbytjen e tyne, dhe bahesha gjithë veshë, jo veç për faktin pse i tregonte aq bukur ngjarjet, po u jepte ngjyra mahnitëse episodeve përmes interpretimit të vet. Më tërhiqte shumë komenti që u bante poezive të ndryshme, po edhe qëndrimi i tij kur kambngulte te theksimi i momenteve dramatike që shtjelloheshin ndër ata libra. Meqë s'ishin shumë, veprat që gjeta aty në Pukë, pata munda me i lexue të tana. E gjej me vend me i përmendë nji për nji krejt ata libra, duke kujtue edhe fragmente bisedash që shkëmbej me Milloshin gjatë leximeve.

Fillimisht u hodha nji sy titujve, shfletova parathaniën e secilit libër dhe krijova njifarë ideje rreth përmbytjes së tyne. Mund me thanë se ata libra u banë para meje nji dritare e hapun drejt thesarit të kulturës botnore. Deri at'herë kisha lexue "kuturu", çka m'kishte ra në dorë, domosdo duke krijuë edhe njifarë tollovië ndër mendime të mia. Aty në shkollë të Pukës, po niste kontakti im i parë me letërsinë moderne realiste, kryesisht ndër ata libra me përmbytje të thellë sociale. Aty, m'u desht me vendosë njifarë rregulli, mbasi leximet e mia kishin qenë pa ndonji synim të qartë e pa ndonji objektiv të përcaktuem. Thjesht lexime!

Të nesërmen, ndërsa Milloshi po futesh në mësim, më tha: – Kur t'mërzitesh, si të kam thanë, kalo kah biblioteka. E kam porositë edhe Cvetkën, "Lazri mundet me marrë çdo

libër që t'i nevojitet!"

Të parin libër, që zgjedha për lexim ishte romani "Roza Blanka". Titulli m'u duk disi romantik dhe mendova se aty kisha me gjetë diçka të përshtatshme për moshën time, i nxitun edhe nga mungesa e asaj kulture solide në përzgjedhje, siç shpjegova edhe ma nalt. I kisha kalue dyzet faqet e para, kur ra zilja e pushimit. Milloshi doli prej mësimit dhe u fut në dhomë të vet ku më gjeti duke lexue te qoshja e punës së vet. Ishte në qejf dhe posa m'pa, me at buzëqeshjen karakteristike të pikturueme lehtas, më recitoi vargun e parë të rapsodisë popullore mbi "Luftën e Kosovës"...

Më gëzoi humori i tij, ajo konfidencë, që përditë e ma tepër shembte çdo pengesë mes nesh e natyrshëm po më bahej si shokët e mi të gjimnazit. Tash para meje s'ishte ma ai Migjeni poet, që jetonte i mbyllun në tempullin e artit të vet, po mësuesi Millosh Nikolla, me të cilin ishim ba miq prej kohësh e flisnim sikur koha mes nesh kishte rrjedhë prej kur s'mbahesh mend... Doemos, menjherë u çova në kambë dhe e pyeta si i kishte shkue ora e mësimit. Me mimikën e fytyrës së tij shprehu kënaqsi. Pa librin që kisha në dorë, i hodhi nji sy titullit dhe më pyeti:

– A ke ndigjue gjë për kët vepër?

– Jo asgja! – i thashë

– Autor i librit asht njifarë B. Traven.

P.S. B. Traven (disa herë i cilësuem edhe si Bruno Traven) – asht pseudonimi i nji shkrimtari që besohet të jetë i gjuhës gjermane, mjaft aktiv gjatë gjysmës së parë të Nantëqindës, por që e ka ruejtur të msheftë identitetin e tij...

Sigurisht ky s'asht emni i tij i

vërtetë, po thjesht nji pseudonim. Kam lexue nji artikull të botuem në nji revistë të Beogradit, ku thuhej se janë përpjekë me e zbulue emnin e tij të vërtetë, po ka qenë e pamundur. Ai lufton me çdo kusht me e ruejtë anonimatit. Kështu edhe Shtëpia Botuese asht e detyrueme me ia ruejtë kët msheftësi klientit të vet. Libri asht i bukur dhe mjaft interesant. Besoj se e ke zgjedhë kët libër duke mendue se ke me gjetë lule shpirti, randofilë të ndezun e sentimente, po në t'vërtetë asht nji dramë e thellë shoqnore e njerzore. "Roza Blanka" quhej nji vendbanim i indianëve t'Amerikës së Veriut. Banorët e atij vendi jetonin vërtet të lumtun. Uashingtoni, e kishte nënshtrur krejt popullsinë e atij vendi, e megjithatë u kishte lanë vend me jetue të lirë simbas traditave dhe zakoneve të trashgueme brez mbas brezi. Kësisoj të dyja palët ishin të knaquana.

N'at trevë të mrekullueshme ku sundonte qetsia dhe rregulli e s'njifeshin as ligje, as dekrete ... të gjithë u bindeshin dhe respektonin çdo urdhën që vinte prej kryeqytetit... Nji ditë prej ditësh, qetsia n'at parajsë lumnie mori fund. Tri karroca me njerëz të ardhun prej visesh të panjoftuna, nisën me ngrejtë çadrat mbi rrafshinë. Vendosën do konstruksione të habitshme për banorët vendas që zhurmonin dhe shponin vazhdimisht tokën... Mbas do kohe "Roza Blanka" u shpall zonë e pasun naftëmbajtse. Nëse ta kallzoi se ç'ka ndodhi ma vonë, ti e humb interesin me e lexue deri në fund librin, pra po e ndërpres këtu rrëfimin tim, që ti të vazhdosh punën tande e unë të shkoj në detyrën time, pse sot kena edhe mbledhje me krejt mësuesit e zonës ...

Pse ndjejmë nostalgji?



Në fund të shekullit të 17-të, një student i mjekësisë i quajtur Johannes Hofer vuri re një sëmundje të çuditshme, e cila prekte mercenarët zviceranë që shërbenin jashtë vendit. Simptomat e saj, duke përfshirë lodhjen, pagjumësinë, rrahjet e parregullta të zemrës, dispepsinë dhe ethet ishin aq të forta sa ushtarët shpesh duhej të largoheshin nga detyra. Siç zbuloi Hofer, shkaku nuk ishte ndonjë shqetësim fizik, por një dëshirë e zjarrtë për vendlindjen e tyre malore. Ai e quajti gjendjen nostalgji, nga greqishtja “nostos” që do të thotë kthim në shtëpi, dhe “algos”, dhimbje prej mallit. Në fillim, nostalgjia u konsiderua si një vuajtje veçanërisht zvicerane. Disa mjekë sugjeruan që zhurma e vazhdueshme e zileve të lopëve në Alpe shkaktonte

trauma në daullet e veshit dhe trurin. Komandantët madje i ndaluan ushtarët e tyre të këndonin këngë tradicionale zvicerane, nga frika se do të çonin në dezertim ose vetëvrasje. Por me rritjen e migrimit në mbarë botën, nostalgjia u vu re në grupe të ndryshme. Doli se kushdo që ndahej nga vendlindja për një kohë të gjatë ishte i prekshëm nga nostalgjia. Dhe nga fillimi i shekullit të 20-të, profesionistët nuk e shihnin më atë si një sëmundje neurologjike, por si një gjendje mendore të ngjashme me depresionin. Psikologët e asaj kohe spekuluan se ajo përfaqësonte vështirësi për të lënë fëmijërinë, apo edhe dëshirën për t'u kthyer në gjendjen e fetusit. Por gjatë disa dekadave të ardhshme, kuptimi i nostalgjisë ndryshoi në dy mënyra të rëndësishme.

Ai u zgjerua nga rrëfimi i mallit për shtëpinë, në një dëshirë të përgjithshme për të kaluarën. Dhe në vend se një sëmundje e tmerrshme, ajo filloi të shihej si një përvojë prekëse dhe e këndshme. Ndoshta shembulli më i famshëm i kësaj u rrok nga autori francez Marsel Proust. Ai përshkroi se si shijimi i një torte madeleine që nuk e kishte ngrënë që nga fëmijëria, shkaktoi një kaskadë asociimesh të ngrohta dhe të fuqishme shqisore. Atëherë, çfarë e shkaktoi një ndryshim kaq të madh në këndvështrimin tonë për nostalgjinë? Një pjesë e saj ka të bëjë me shkencën. Psikologjia u largua nga teoria e pastër dhe drejt vëzhgimit empirik më të kujdesshëm dhe sistematik. Pra, profesionistët kuptuan se shumë nga simptomat

negative mund të kenë qenë thjesht të lidhura me nostalgjinë dhe jo të shkaktuara prej saj. Dhe, në fakt, pavarësisht se është një gjendje emocionale komplekse që mund të përfshijë ndjenjat e humbjes dhe trishtimit, nostalgjia në përgjithësi nuk i fut njerëzit në një humor negativ. Në vend të kësaj, duke i lejuar individët të kujtojnë përvojat personale kuptimplota dhe shpërblyese që kanë ndarë me të tjerët, nostalgjia mund të rrisë mirëqenien psikologjike. Studimet kanë treguar se nxitja e nostalgjisë tek njerëzit mund të ndihmojë në rritjen e ndjenjave të tyre të vetëvlerësimit dhe përkatësisë sociale, të inkurajojë rritjen psikologjike dhe madje t'i bëjë ata të veprojnë më mirë. Pra, në vend që të jetë shkaktare e shqetësimit mendor, nostalgjia mund të jetë një

mënyrë shëruese për ta përballuar atë. Për shembull, kur njerëzit përjetojnë gjendje emocionale negative, ata priren të përdorin natyrshëm nostalgjinë për të reduktuar shqetësimin dhe për të rikthyer mirëqenien. Sot, duket se nostalgjia është kudo, pjesërisht sepse reklamuesit kanë zbuluar se sa e fuqishme është ajo si një teknikë marketingu. Është joshëse të mendosh për këtë si një shenjë se ne jemi të mbërthyer në të kaluarën, por nostalgjia nuk funksionon kështu. Në vend të kësaj, nostalgjia na ndihmon të kujtojmë se jeta jonë mund të ketë kuptim dhe vlerë, duke na ndihmuar të gjejmë besimin dhe motivimin për të përballuar sfidat e së ardhmes. / TED Talks – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Malisheva merr edhe Maliqin, Dukagjini zyrtarizon Zhdrellën dhe Nikoliqin

Klubet e Superligës vazhdojnë të jenë aktive në këtë afat kalimtar, duke realizuar transferimet e radhës. Malisheva e ka kompletuar transferimin e katërt që është Behar Maliqi, kurse Dukagjini i Klinës e ka angazhuar Mentor Zhdrellën dhe sulmuesin nga Mali i Zi, Stefan Nikoliq



EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 JANAR - Pas Labint Ibrahimit, Fidan Gërbeshit e Xhevdet Shabanit, skuadra e Malishevës e ka realizuar edhe transferimin e katërt për këtë afat kalimtar. Ky klub e ka paraqitur mesfushorin me përvojë të madhe, Behar Maliqin, i cili në sezonin vjeshtor ishte pjesë e Feronikelit, derisa në të kaluarën me sukses ka luajtur edhe për Prishtinën dhe Llapin. "Behar Maliqi konsiderohet një nga mesfushorët mbrojtës më të mirë në Superligë. Maliqi vlerësohet për aftësinë e tij për ta rifitur topin në mesfushë dhe për të konvertuar shpejt posedimin. Leximi i tij i lojës është konsideruar i jashtëzakonshëm. Transferimi i tij në FC Malisheva është një nga transferimet e duhura duke pasur parasysh përvojën e tij dhe maturitetin që ai sjell në skuadrën tonë.

Karrierën si futbollist Maliqi e filloi me FC Prishtinën e më pas duke lënë kampionatin e Kosovës ku u transferua te KF Partizani për sezonin 2013-2014. Pas një sezoni të mirë në kampionatin shqiptar, Maliqi rikthehet në Superligë, ku nënshkroi me Feronikelin. Luajti për Llapin, përsëri për Prishtinën, së fundmi ishte prapë pjesë e FC Feronikelit", thuhet në njoftimin e skuadrës së Malishevës.

Mjaft aktive është treguar edhe skuadra e Dukagjinit, e cila ka zyrtarizuar transferimin e katër herë futbollistit më të mirë në Kosovë, Mentor Zhdrella. "Mentori ka një karrierë të pasur në futbollin kosovar. Ai në të kaluarën ishte pjesë e shumë skuadrave në futbollin tonë. Është paraqitur me disa klube të ndryshme. 'Hysi', 'Prishtina', 'Feronikeli' janë vetëm disa nga klubet me të cilat ai është aktivizuar në të kaluarën. Klubi i fundit me të cilin është paraqitur

Zhdrella për një periudhë katërvjeçare është skuadra e KF Llapit, klub në të cilin ishte edhe kapiten në dy edicionet e fundit. Mentori ishte përballur me një lëndim i cili e la jashtë fushës së gjelbër për disa muaj, e tash pasi e ka tejkaluar do të jetë një ndihmesë e madhe për klubin me përvojën e tij dhe karrierën e pasur që ka pas vetë", ka njoftuar skuadra e Dukagjinit.

Të dielën skuadra nga Klina e ka zyrtarizuar edhe transferimin e sulmuesit nga Mali i Zi, Stefan Nikoliq. Nikoliq, i lindur më 16 prill 1990, luan në pozitën e sulmuesit qendror dhe ka një karrierë të pasur si futbollist. Nikoliq ka luajtur edhe në disa klube me nam në futbollin evropian si "Steaua Bukuresht" (Superliga Rumune), "CSKA Sofia" (Superliga bullgare), "Sutjeska Niksiq" (Superliga Malit të Zi), "NK Istra" (Superliga Kroate), e "Melaka" (Superliga e Malajzisë).

SHKURT

Hapet afati kalimtar i janarit në volejboll

Nga data 15 janar është hapur afati kalimtar në volejbollin e Kosovës, njofton FVK-ja. Kjo periudhë është mundësi e mirë për angazhim të ndonjë ekipi ri për volejbollistët/et që nuk kanë qenë të angazhuar/a në ndonjë klub gjatë stinorit vjeshtor. Afati është i hapur edhe për transferimin e volejbollistëve të huaj në dy gjinitë përmes sistemit elektronik për transfere, 'VIS'. Klubet kanë kohë të bëjnë lëvizje deri më 31 janar në orën 18:00, kur mbyllet zyrtarisht afati kalimtar, sipas rregullores së kalimit të lojtarë(e)v.

'Vendim skandaloz', kryeministrja e Serbisë reagon për deportimin e Djokoviqit nga Australia

Kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabiq, reagoi ashpër këtë ditë pas vendimit të Australisë për ta deportuar yllin serb të tenisit, Novak Djokoviq, në prag të Australian Open, pasi ai udhëtoi pa u vaksinuar. Brnabiq e quajti vendimin e Gjykatës së Apelit skandaloz, ndërsa shtoi se 34-vjeçari do të jetë gjithmonë i mirëpritur në atdhe. "Mendoj se vendimi i gjykatës është skandaloz. Më duket e pabesueshme që kemi dy vendime gjykatë krejtësisht kontradiktore brenda harkut të vetëm disa ditësh. Jam e zhgënjyer. Ky vendim tregoi se si funksionon sundimi i ligjit ose, më mirë të themi, se si nuk funksionon në disa vende. Në çdo rast mezi pres ta shoh Djokoviqin në atdheun tonë në Serbi", ka thënë kryeministrja.

Ylli nënshkruan me Makel Mawien

Klubi i Basketbollit Golden Eagle Ylli ka njoftuar se ka nënshkruar me amerikanin Makel Mawien. Këtë e ka bërë me dije klubi nga Suhareka përmes një postimi në "Facebook". "Makol Mawien i bashkohet rrugëtimit tonë për titullin kampion. Mirë se vjen, Mawien!", thuhet në njoftim.

Hadergjonaj shënon gol për Kasimpasan

Florent Hadergjonaj është bërë protagonist në xhiron e 21-të në Superligën e Turqisë. Mbrojtësi shqiptar ka arritur të gjejë golin në përballjen që Kasimpasa e zhvilloi në udhëtim te Giresunspor. Hadergjonaj mori përgjegjësinë e penalltisë në minutën e 64-t dhe realizoi një gol të bukur për 0-2. Me këtë fitore Kasimpasa ngritet në vendin e 16 në Superligën e Turqisë me 21 pikë të tubuara. Për Hadergjonajn ky ishte goli i parë në Superligën e Turqisë këtë edicion, teksa ka bërë edhe një asistim.

Evertoni shkarkon Benitezin

Skuadra e Evertonit ka konfirmuar shkarkimin e trajnerit Rafael Benitez. Shkarkimi i Benitezit ishte shkaku i rezultateve negative, e sidomos humbja ndaj Norwichit. Përmes një komunikate zyrtare skuadra nga Liverpooi konfirmoi shkarkimin e Benitezit. "Evertoni konfirmon largimin e Rafael Benitezit nga pozita e trajnerit të ekipit të parë", shkroi klubi në komunikatë.

Erikseni, afër rikthimit në Premierë Ligë

Kristian Eriksen është gati të rikthehet të luajë futboll. Këtë lajm e ka bërë publik "Times", ku shkruan se ylli danez do të firmosë me një klub të Premierë Ligës. Në shtatë muaj

distancë nga ai makth i përjetuar në Kampionatin Evropian në ndeshjen ku danezi ndaj Finlandës pësoi një atak kardiak, ku vendimtare ishin ndërhyrjet e

mjekëve dhe të lojtarëve në kohën e duhur për t'i shpëtuar jetën ish-mesfushorit të Interit. "Times" nuk e zbulon emrin e klubit që Erikseni pritet të rifillojë edhe një herë karrierën

futbollistike pas atij tmerri të përjetuar. Ai gjatë disa intervistave të ndryshme ka pranuar se dëshiron të jetë me çdo kusht në Botërorin e Katarit që do të zhvillohet në

nëntorin e këtij viti. Mesfushori u largua nga Interi pasi shteti italian e ka të ndaluar rreptësisht aktivizimin në futboll të lojtarëve me debriflator në zemër.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

